



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 10229 Prot.

Tiranë, më 21.10.2014

URDHËR

Nr. 1937. Datë 21. 10.2014

MBI PËRCAKTIMIN E DETYRIMIT TË SUBJEKTEVE PËR TË ZËVENDËSUAR SIPËRFAQET PYJORE DHE PËRMIRËSUAR SIPËRFAQET KULLOSORE QË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR NËPËRMJET PYPËLLËZIMIT, RIPYPËLLËZIMIT DHE PERMIRËSIMIT TË TYRE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, gërmën ‘dh’ të nenit 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të gërmës “ç” të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 9 dhe 12 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” të VKM-së Nr. 1353 datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, të VKM-ve Nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” në Programin e Qeverisë për përmirësimin e mjedisit nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të sipërfaqeve pyjore,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe kullosore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullosor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre, detyrim i cili do të jetë:

A. Për fondin pyjor:

a. E barabartë me 3 (tre) fishin e sipërfaqes që hiqet nga fondi pyjor për pyjet trugishte.

b. E barabartë me sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor për pyjet me formë qeverimi cungishte dhe shkurre, si dhe për sipërfaqet me bimësi pyjore.

B. Për fondin kullosor

a. Përmirësim kullote e barabartë me 2(dy) fishin e sipërfaqes kullosore që hiqet nga fondi kullosor.



2. Detyrimi për pyllëzim, ripyllëzim dhe rehabilitim kullote do të përcaktohet në dokumentin (Urdhërin e ministrit të MM-së, VKM-së apo Ligj) që vendos për heqje të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore nga fondi pyjor dhe kullor kombëtar, me qëllimin për t'u kthyer në truall, zgjerim të vijës kufizuese dhe të shtrirjes territoriale të qendrave të banuara, për ndërtim të strukturave turistike, për ndërtim të rrugëve automobilistike, linjave të tensionit të lartë dhe të tubacioneve të gazit, veprimtaritë minerare e gjeologjike, ndërtim të hidrocentraleve etj.
3. Procesi i pyllëzimit apo ripyllëzimit, rehabilitimi i sipërfaqes kullimore do të realizohet nga përfituesi me fondet e saja brenda afatit kohor të përcaktuar në aktin sipas pikës 2 të këtij urdhëri.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, brenda 20 (njëzet) ditëve nga dalja e këtij Urdhëri përcakton kriteret për hartimin e projekteve teknike dhe procedurat për monitorimin dhe realizimin e pyllëzimeve.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse harton dhe miraton tipin e marrëveshjes që lidhet ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe subjekteve përfituese me detyrimet përkatëse sipas pikës 1 (një) të këtij urdhëri, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga dalja e tij.
6. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mjedisit dhe Jetësimit të Prioriteteve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor.
7. Urdhëri Nr. 1820, datë 17.06.2014 "Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të tyre", shfuqizohet.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



LEFTER KOKA

MINISTËR